

MARRËVESHJE PËR BASHKËPUNIM

midis

Kolegji-t “Universum”

dhe

Single Parent Association

Qëllimi i marrëveshjes

Me këtë marrëveshje palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin e mirë dhe gatishmërinë për bashkëpunim. Kolegji “Universum” në kuadër të misionit të saj për ndërtim dhe zhvillim të komunitetit në Kosovë, si institucion privat i Arsimit të Lartë, ka vendosur që në bashkëpunim me Association for Single Parents, të kontribuojë në edukimin e nënave vetëushqyese, me qëllim të rritjes së barazisë gjinore, fuqizimit ekonomik të grave në Kosovë, rritjen e qasjes së nënave vetëushqyese në edukim dhe rritjen e kapacitetit të tyre konkurrues në tregun e punës. Ky kontribut i Kolegjit “Universum” bëhet në kuadër të Objektivës 1, 4 dhe 5 të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm – me qëllim të uljes së varfërisë përmes edukimit.

Palët e kësaj marrëveshje, zotohen për bashkëpunim në fusha të ndryshme, që ndërlidhen me aktivitetet e edukimit dhe avancimin e nënave vetëushqyese, përmes qasjes në arsimim dhe zhvillim të mëtutjeshëm pa diskriminim, mbështetur në parime të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Marrëveshja hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit të saj nga e palëve të kësaj marrëveshjes.


Palët nënshkruese:

Single Parent Association


Arjefa Gashi – Drejtore Ekzekutive

Datë: 09 / 11 / 2021

Kolegji UNIVERSUM


Arlinda Qehaja – Kolegji Universum

Datë: 09 / 11 / 2021